REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVLJA/MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.jedinica / Org. Unit: 02
No.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 05-4862
Nr.i faqeve / Broj stranica / No.pages: -3-
Data: / Datum: / Date: 10 / 07 / 2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health / Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE (PSO)

EMRI I PSO: SKRININGUT TË KANCERIT KOLOREKTAL NË KUJDESIN PARËSOR SHËNDETËSOR

PËRMBAJTJA: PËRCAKTIMI I HAPAVE PWR ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E SKRININGUT PËR KANCERIN KOLOREKTAL, PËRFSHIRË: IDENTIFIKIMIN E HERSHËM TË PERSONAVE ME RREZIK PËR KANCER KOLOREKTAL DERI NË KONFIRMIMIN E REZULTATIT POZITIV TË TESTIT FIT

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT: 09.07.2026.
AUTOR: MSH
NR. I HAPAVE:VIII
NR. I NËNHAPAVE 22

APROVUAR: Z. Jahë Gecaj
UD. Sekretar i Përgjithshëm, MSh

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH
Prishtinë / Va

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PROCEDURE ËSHTË PËRCAKTIMI I HAPAVE STANDARD PËR IDENTIFIKIMIN, INFORMIMIN, TESTIMIN DHE REFERIMIN E PERSONAVE TË GRUPMOSHËS TARGET PËR SKRININGUN E KANCERIT KOLOREKTAL ME TESTIN FIT, ME QËLLIM TË ZBULIMIT TË HERSHËM TË SËMUNDJES DHE ULJES SË MORTALITETIT NGA KANCERI KOLOREKTAL.
AKTET NËRLIDHËSE	LIGJI NR. 04/L-125 PËR SHËNDETËSI LIGJI NR. 02/L-78 PËR SHËNDETIN PUBLIK PLANI I VEPRIMIT PËR SKRININGUN E KANCERIT KOLOREKTAL
PËRKUFIZIME	• KANCERI KOLOREKTAL - SËMUNDJE MALINJE QË PREK ZORRËN E TRASHË DHE/ OSE REKTUMIN. • SKRINING - PROCES SISTEMATIK I TESTIMIT TË INDIVIDËVE PA SIMPTOMA PËR ZBULIMIN E HERSHËM TË SËMUNDJES OSE NDRYSHIMEVE PREKANCEROZE. • POPULLATA TARGET - INDIVIDËT E MOSHËS 50–74 VJEÇ (OSE SIPAS POLITIKAVE KOMBËTARE NË FUQI). • TESTI FIT (FECAL IMMUNOCHEMICAL TEST) - TEST LABORATORIK PËR ZBULIMIN E GJAKUT OKULT NË FEÇE. • REZULTAT POZITIV - REZULTAT I TESTIT FIT QË TREGON PRANI TË GJAKUT OKULT DHE KËRKON HETIME TË MËTEJSHME. • REZULTATI NEGATIV- REZULTAT I TESTIT FIT QË NUK TREGON PRANI TË GJAKUT OKULT DHE KËRKON HETIME TË MËTEJSHME. • KOLONOSKOPIA - PROCEDURË DIAGNOSTIKE PËR EKZAMINIMIN E ZORRËS SË TRASHË DHE IDENTIFIKIMIN E LEZIONEVE TË MUNDSHME. • REFERIMI - PROCESI I DËRGIMIT TË PACIENTIT NGA NJË NIVEL I KUJDESIT SHËNDETËSOR NË TJETRIN PËR DIAGNOSTIKIM OSE TRAJTIM TË MËTEJSHËM.

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Identifikimi i popullatës target	1. Mjeku familjar në QKMF identifikon qytetarët e moshës 50-74 vjeç bazuar në regjistrat shëndetësorë; 2. Qytetarët regjistrohen në databazën e skriningut; 3. Verifikohet përshtatshmëria e tyre për pjesëmarrje në skrining.
[II]	Ftesa dhe informimi	1. QKMF kontakton qytetarët e targetuar përmes formave zyrtare të komunikimit; 2. Qytetarët informohen për qëllimin dhe procedurën e skriningut; 3. Caktohet koha për marrjen e testit.
[III]	Shpërndarja e testit FIT dhe udhëzimi i pacientit	1. Mjeku familjar ose infermieri e pajis qytetarin me testin FIT 2. Jepen udhëzime për marrjen e mostrës; 3. Qytetari informohet për afatin dhe mënyrën e dorëzimit të mostrës.
[IV]	Marrja dhe dorëzimi i mostrës	1. Qytetari merr mostrën sipas udhëzimeve të dhëna; 2. Mostra dorëzohet në QKMF brenda afatit të përcaktuar; 3. Mostra pranohet, verifikohet dhe regjistrohet nga personeli përgjegjës i QKMF.
[V]	Transporti dhe analiza laboratorike	1. Mostrat transportohen në laborator të licencuar sipas procedurave të përcaktuara; 2. Kryhet analiza për identifikimin e gjakut ne feces (FIT); 3. Rezultatet regjistrohen dhe dokumentohen në sistem.
[VI]	Raportimi dhe interpretimi i rezultateve	1. Laboratori dërgon rezultatet në QKMF; 2. Mjeku familjar i interpreton rezultatet; 3. Qytetari informohet për rezultatin e testit.
[VII]	Menaxhimi i rezultateve	1. Rezultatet negative regjistrohen dhe qytetari planifikohet për skrining rutinë të radhës sipas programit; 2. Rezultatet pozitive evidentohen dhe pacienti informohet për nevojën e ekzaminimeve të mëtejshme/referim.
[VIII]	Referimi i rasteve për FIT pozitiv	1. Mjeku familjar bën referimin në nivelin sekondar/terciar për vlerësim specialistik dhe kolonoskopi; 2. Pacienti regjistrohet për diagnostikim sipas protokollit të programit, sipas PSO II për Menaxhimin e pacientëve me rezultat FIT Pozitiv.